



Koalicioni Shqiptar “Bashkë Kundër Trafikimit të Fëmijëve”  
The Albanian Coalition “All Together Against Child Trafficking”

## Njoftim për shtyp

### Së bashku kundër Punës dhe shfrytëzimit të fëmijëve *Bëj Gol-Jepi fund punës së Fëmijëve!*

**10 Qershor 2010, Tiranë**, Me rastin e Ditës Botërore Kundër Punës së Fëmijëve Koalicioni “Së Bashku kundër Trafikimit të Fëmijëve” realizoi evenimentin ndërgjegjësues pranë Kompleksit Dinamo. Ky event synonte të ndërgjegjësojë publikun, qeverinë, punëdhënësit etj, mbi shfrytëzimin e fëmijëve për punë.

Qindra fëmijë, Zj. Iva Zajmi, Znj. Nora Malaj, Ambasadori Hollandez Z. Henk Van den Dool, futbollisti Z. Altin Lala, përfaqësues nga MPCSSHB dhe nga Bashkia Tiranë, përfaqësues nga Ambasada Amerikane, rreth 30 organizata joqeveritare që punojnë drejtëpërsëdrejti me fëmijët në nevojë morën pjesë në këtë event për të tërhequr shprehur vullnetin e tyre ndaj mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

“Është e patolerueshme që një vend i anëtarësuar në NATO të ketë akoma fëmijë të cilët shfrytëzohen për punë”, tha Ambasadori Hollandez.

Fenomeni i punësimit të të miturve është mbarëbotëror. Shumë fëmijë punojnë të shtrënguar, kryesisht nga kushtet ekonomike dhe situata konflikti. Edhe në Shqipëri ka me qindra fëmijë që punojnë për të mbajtur familjet e tyre. Pavarësisht se nga raporti i MPCSSHB (2010) në Shqipëri, rreth 540 fëmijë punojnë në sektorin formal dhe 315 të tjerë janë të përfshirë në format më të këqija të punës, veçanërisht fëmijë që punojnë në rrugë, fëmijë viktime dhe në rrezik trafikimi e shfrytëzimi seksual përsëri ngelen jashtë këtyre shifrave fëmijët e paregjistruar dhe të paidentifikuar.

Kjo situatë është e patolerueshme. Pasi fenomeni i punës së fëmijëve krijon një cikël varfërie që pengon familjet dhe kombet për të përdorur potencialin e tyre të plotë. Por mbi të gjitha duhet të kujtojmë se fëmijët kanë të drejtën e një jete pa shfrytëzim, të një jete të denjë, në të cilën iu respektohen të drejtat, të arsimohen dhe iu plotësohen kushtet për mirërritje.

Shkatërrimi i ciklit të varfërisë është një sfidë. Por ajo duhet filluar nga mbrojtja e fëmijëve, nga heqja e tyre prej kthetrave të shfrytëzimit, nga sigurimi i të drejtave të tyre. Lind nevoja për krijimin dhe ofrimin e shërbimeve direkte nga vetë shteti për fëmijët në nevojë, për marrjen e përgjegjësisë nga shteti, nga shkollat nga familjet dhe të gjithë institucioneve. Çdo njeri duhet të ndërgjegjësohet që fëmijët të rriten të lumtur dhe me të gjitha të drejtat të garantuara.

Gjatë fjalimit të tij Z. Lala u kërkoi të gjithë fëmijëve që ashtu si dënohen me kartonin e kuq të gjithë ata që dëmtojnë të tjerët dhe ne të dënojmë ata që dëmtojnë fëmijët. Rreth 500 fëmijë së bashku ngritën kartonin e kuq duke thirrur **“Jepi fund punës së fëmijëve”**.

Aktiviteti vazhdoi me lojra për fëmijë të cilët përçonin mesazhe të mosdiskriminimit, të bashkëpunimit dhe të respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Për informacione të mëtejshme kontaktoni: Danjela Shkalla, Koordinatore e Koalicionit BKTF

E-mail: danjela.shkalla@bktf-coalition.org  
Tel: +355 68 20 26 662

Koalicioni kombëtar “Së Bashku kundër Trafikimit të Fëmijëve” është një koalicion prej 25 organizatash të cilat punojnë me shumë përkushtim në luftën kundër trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve në Shqipëri dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të rritur efektivitetin e ndërhyrjeve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.